

## **DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET ME KËRKESËN PËR NJOHJEN E DOKUMENTEVE TË SHKOLLIMIT TË LARTË PËR ARSYE PUNËSIMI**

1. Formularin elektronik të shtypur dhe të nënshkruar
2. Përkthimin e vërtetuar të diplomës – në 3 shembuj.
3. Përkthimin e vërtetuar të shtojcës së diplomës (po nëse egziston) – në 3 shembuj.
4. Përkthimin e vërtetuar të transkriptit sipas semestrave dhe viteve (po nëse nuk është pjesë kryesore e shtojcës së diplomës) – në 3 shembuj.
5. Fotokopjen e origjinalit të diplomës.
6. Fotokopjen e origjinalit të transkriptit të provimeve sipas semestrave dhe viteve.
7. Po nëse dokumentet janë nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi, është e nevojshme që t'i bashkangjiten fotokopjet e vërtetuara – në 3 shembuj.
8. Originalin e diplomës **në shqyrtim** (në shikim) me rastin e dorëzimit të dokumentacionit në Ministri.
9. Fotokopjen e vërtetuar të diplomës së huaj të shkollimit të mëparshëm me transkriptën e notave apo shtojcën e diplomës. **Në rast diploma e huaj e fituar më parë vetëm se është njohur nga universitetet në Republikën e Serbisë, duhet të dorëzohet vendimi.**
10. Biografinë në gjuhën serbe ose angleze nga e cila duhet të shihet rrjedha e studimeve
11. **Për njohjen e studimeve të doktoraturës** është e nevojshme që të bashkangjitet kopja e tezës së doktoraturës në gjuhën që është shkruar, apstraktin e zgjëruar të tezës në gjuhën serbe ose angleze dhe listën e punimeve shkencore të publikuara.
12. Vendimin e organit kompetent ose fotokopjen e certifikatës së martesës (për personat të cilët kanë ndryshuar emrin apo mbiemrin) – po nëse egziston nevoja.
13. Vërtetimin e pagesës së Taksës për njohje profesionale të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë i cili gjendet në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, përkatësisht Qendrës Eric/Naric Serbia.
14. **Diplomat të lëshuara në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë** në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përveç dokumenteve të cekura më lartë paraqitësi i **kërkesës patjetër duhet të dorëzoj edhe certifikatën e lëshuar nga ana e Asociacionit të Universiteteve Europiane (AUE)**, si dhe përkthimin e vërtetuar të saj në gjuhën serbe.
15. Sëbashku me kërkesën për njohjen e diplomave të huaja të cilat pranohen në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare, paraqitësi i kërkesës duhet të dorëzoj edhe dokumentet **(pika 1. deri në pikën 12.)**
16. Vërejtje:
  - Dokumentet për të cilat kërkohet përkthimi i tyre në gjuhën serbe duhet të jenë të vërtetuara nga ana e përkthyesit të autorizuar gjyqësor.
  - Përgjegjësinë për grumbullimin e dokumenteve, përkatësisht informacioneve adekuate i bartë paraqitësi i kërkesës.
  - Gjatë procedurës mund të kërkohen edhe dokumente tjera relevante për njohjen profesionale

Pranimi i dokumenteve kryhet sipas parimit të caktimit elektronik të terminit (në kuadër të plotësimit të formularit elektronik)

Linku i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik është ky:

<http://www.mpn.gov.rs/enicnarc-srbija>

Linku i formularit: <http://enicnarc.mpn.gov.rs>

Koha e konsultimeve telefonike: **çdo ditë pune prej ora 12 :00 deri 14:00**

Kontakt telefoni: **011/2120772**

E-mail: **jelena.radovanovic@mpn.gov.rs**

Adresa: Nemanjina 22-26, 11000 Beograd, kati i VI (krah C), zyra numër 26